

KONTRATË PAJTIMI
Për Shërbimet e Komunikimeve Elektronike

NR._____

DATË._____/_____/_____

"IBC" SHPK Operator i Shërbimit të Komunikimeve Elektronike që më poshtë do të quhet **OPERATOR**, me seli zyrtare ne adresën: **Rr: Marin Becikemi, Shkoder** me **NIPT L06801002A**.

Dhe

Z/Znj._____ (Emër, Atësia, Mbiemri), me adresë....., me dokument identifikimi Nr._____ që më poshtë do të quhet **PAJTIMTAR**.

Neni 1. Objekti i Kontrates

Ofrimi i Shërbimit te Komunikimeve Elektronike, Aksesit në Internet dhe/ose IPTV nga Operatori "IBC -Telecom" Shpk nëpërmjet rrjetit të tij të komunikimeve elektronike me specifikimet e dhena ne Aneksin 1, sipas kereses së pajtimtarit.

Neni 2 Tarifat, Garancia dhe Sherbimet e ofruara

2.1 Lloji i Shërbimit, parametrat kryesorë të tij si dhe tarifat, të ofruara nga Operatori dhe të pranuara nga Pajtimtari, paraqiten në Aneksin 1 të kësaj Kontrate dhe janë pjesë integrale e Kontratës së nënshkruar midis palëve.

2.2 Tarifat e Shërbimeve janë objekt ndryshimi , të cilat vendosen dhe publikohen sipas kërkesave të ligjit Nr.9918, datë 19.05.2008, " Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Neni 3 Detyrimet e paleve

3.1 Operatori detyrohet të mundësojë për pajtimtarin shërbim të pandërprerë 24 në 24 orë e me cilësi, sipas parashikimeve të kësaj kontrate dhe anekseve të saj.

3.2 Operatori detyrohet të aktivizojë ofrimin e Shërbimit të zgjedhur nga pajtimtari sipas kushteve dhe specifikave të përcaktuara në aneksin në kontratën bashkëlidhur.

3.3 Operatori detyrohet të evidentojë ankesat dhe shqetësimet e Pajtimtarit dhe ta informojë atë për zgjidhjen e mundshme të tyre brenda 24 orëve nga marrja e njoftimit.

3.4 Operatori detyrohet të riparojë defektet teknike dhe të rivendosë ofrimin e shërbimit brenda 24 orëve nga marrja e njoftimit. Në çdo rast këto afate do të llogariten nga momenti i njoftimit në numrat e informacionit të Operatorit, me perjashtim te rasteve kur defektet teknike jane të per gjithshme dhe kur defekti teknik raportohet në diten e shtune, në keto raste zgjidhja e problemit do trajtohet diten e hene, pasardhese nga raportimi i problemi.

3.5 Operatori detyrohet të riaktivizojë shërbimin brenda 24 (njëzetkatër) orëve, nga momenti që Pajtimtari ka shlyer të gjitha detyrimet financiare ndaj Operatorit, por në çdo rast me kusht që pagesa të jetë kryer përfundimit të kontratës.

3.6 Operatori nuk mban përgjegjësi për problemet apo defektet që mund të vijnë si pasojë e përdorimit të Internetit në mënyrë të pavarur nga Pajtimtari si psh. hapjes së faqeve të ndryshme Interneti, shkarkimit të programeve nga Interneti, dëmtimi nga viruset, aplikimi i formave të pagesave online etj.

3.7 Operatori mund të ofrojë pajisje fundore për pajtimtarin nën termat dhe kushtet e percaktuara paraprakisht në anekset e kontratës së pajtimit.

3.8 Operatori detyrohet të marrë dhe të zbatojë masa teknike dhe organizative për të siguruar rrjetin, shërbimin, konfidencialitetin e komunikimit dhe të dhënat e trafikut të komunikimit sipas përcaktimit të ligjit nr. 9918 date 19.05.2008, i ndryshuar.

3.9 Operatori detyrohet të sigurojë kushte për pranimin e pagesave nga Pajtimtari, gjashtë ditë në javë, me orar 08.00 – 19.00.

3.10 Operatori detyrohet të marrë në konsideratë kërkesën për publikimin ose mospublikimin e të dhënavë personale në numëratorin telefonik, kur një gjë e tillë kërkohet nga Pajtimtari, dhe të publikoje vetëm të dhënat për të cilat pajtimtari bie dakort.

3.11 Operatori detyrohet të instalojë Paisjen Fundore në ambientet e Pajtimtarit brenda 1(një) ditë pune, llogaritur nga data e hyrjes në fuqi të Kontratës.

3.12 Operatori duhet të ruajë informacionin sipas kushteve të vendosura në ligj, dhe nëse nuk është përcaktuар për një periudhë 12 muaj, duhet të bëhen të vlefshme për pajtimtarët me kërkesën e tyre me shkrim siç përcaktohet nga ligji.

3.13 Pajtimtari detyrohet të sigurojë kushte për instalimin e shërbimeve dhe pajisjeve të nevojshme për lidhjen e shërbimeve objekt kontrate. Gjithashtu duhet të lejojë në rast nevoje, për realizimin e ofrimit të shërbimit të pajtimtarit, hyrjen në pronat private, të punonjësve të autorizuar të Operatorit .

3.14 Pajtimtari detyrohet te kryejë pagesën për shërbimin e ofruar, sipas mënyrës dhe afateve të përcaktuara në këtë Kontratë dhe anekset e saj si dhe të marrë dhe ruaje kopjen e dokumentave që vërtetojnë kryerjen e veprimeve financiare për pagesën e faturës.

3.15 Pajtimtari detyrohet të likujdojë të gjitha detyrimet financiare ndaj Operatorit, deri ne momentin e prishjes së kësaj kontrate.

3.16 Pajtimtari detyrohet të mos përdorë shërbimin e ofruar për qëllime ilegale, për të shqetësuar, fyri apo kërcënuar Pajtimtarët e tjerë të rrjeteve të telekomunikacioneve apo për të kryer veprat që bien në kundërshtim me Legjislacionin Shqiptar përfshirë këtu edhe thirrjet e gabuara të emergjencës.

3.17 Pajtimtari detyrohet të mos përdorë shërbimin për qëllime rishitje dhe te mos transferojë shërbimin në palët e treta, per asnjë arsyjeje.

3.18 Pajtimtari detyrohet të mos ofrojë në çdo formë, për një arsy apo jo, as të krijojë kushte për kopjim, regjistrim, ritransferim ose përdorim të përbajtjes dhe shërbimeve për qëllime të tjera, dhe pakapërcim ose përpjekje të kapërcejë mekanizmat për mbrojtjen e programeve kundër veprimeve të tillë dhe/ose përdorime të paautorizuara.

3.19 Pajtimtari detyrohet të mirëmbajë dhe te mos demtoje paisjet e dhena ne perdorim nga Operatori, sipas udhëzimeve të tij. Po ashtu Pajtimtari nuk duhet të vendose në pajisjet fundore të cilat janë në pronësi të Operatorit si ushqyes, fishe etj, të cilat nuk janë të autorizuara nga Operatori. Në raste se pajisjet në përdorim dëmtohen për shkak të ndërhyrjes nga Pajtimtari ai detyrohet t'i paguaje ato.

3.20 Pajtimtari detyrohet të mos kalojë apo transferojë te të tretët të drejtat dhe detyrimet ndaj Operatorit sipas kësaj kontrate, pa miratimin me shkrim të këtij të fundit.

3.21 Pajtimtari dhe Operatori detyrohen të njofojnë njeri-tjetrin, për ndryshim e të dhënavë të tyre identifikuese, apo të dhënavë të komunikimit mes palëve, brenda 10 ditëve nga ndryshimi i tyre. Mungesa e këtij njoftimi, do të shkarkojë Operatorin dhe Pajtimtarin nga cdo përgjegjësi.

3.22 Pajtimtari detyrohet të mos kryej apo lejojë, përvëçse me miratimin e operatorit, gjenerimin, terminimin, tranzitimin apo devijimin e trafikut nga apo tek rrjeti i Operatorit duke përfituar nga një person i ndryshëm nga ai, ose ndonjë gjenerim artificial apo devijim të trafikut të paligjshëm duke përdorur shërbimet e kontraktuara.

3.23 Pajtimtari është i detyruar të lejojë Operatorin të vendose emrin e tij tregtarë “I.B.C-Telecom”, në WiFi e tijë përdorues, pa asnjë penalitet.

Neni 4. Te drejtat e paleve kontraktuese.

- 4.1 Operatori ka te drjte t'i ndërpresë ofrmin e Shërbimit dhe ose shërbimeve, pajtimtarit i cili nuk ka zbatuar detyrimet që rrjedhin nga përcaktimet e kësaj kontrate.
- 4.2 Operatori ka të drejte të ndërpresë shërbimin objekt kontrate në mënyrë të njëanshme, duke njoftuar të paktën 24 orë më përpara, për qëllime mirëmbajtje dhe përmirësimin e shërbimit. Kohëzgjata e ndërprerjes të jetë jo më shumë se 48 orë.
- 4.3 Operatori ka të drejte të modifikojë elementet e Kontratës, përfshirë këtu rastet për nevoja të pështatjeve me teknologjitë e reja, apo ndryshimet ligjore, duke njoftuar pajtimtarët jo më pak se 30 ditë përpara hyrjes në fuqi të modifikimeve.
- 4.1.4 Operatori ka të drejte të ketë akses në godinat e pajtimtarëve mbas një njoftimi me shkrim dhe marrveshjeje për një periudhë jo më të vogël se 24 (njëzet e katër) orë me telefon apo email.
- 4.5 Operatori ka të drejte të refuzojë shërbimin e garantuar sipas kontratës së pajtimit, kur pajtimtari ka ndërmarrë vetë apo ka lejuar palë të treta të paautorizuara të marrin përsipër instalimin, modifikimin apo riparimin e pajisjeve dhe/ose të rrjetit.
- 4.6 Operatori nuk do të jetë i detyruar ndaj pajtimtarit për:
- 4.6.1 Dëmin që nuk i atribohet direkt apo drejtpërdrejt drejtimit të keq të tij;
- 4.6.2 Dëmit të shkaktuar nga thirrjet e dështuara;
- 4.6.3 Mosplotësim të detyrimeve të tij për shkak të një force madhore gjatë kohëzgjatjes së saj.
- 4.6.4 Përmbajtjen e informacionit të transmetuar nëpërmjet rrjetit;
- 4.6.5 Ndërprerjen dhe/ose cilësinë e dobët të shërbimeve të komunikimeve elektronike kur kjo është në kufij të parametrave teknikë dhe cilësinë e rrjeteve të tjera të komunikimeve elektronike, si dhe dëmet dhe/ose prishjet në këto rrjete;
- 4.6.6 Ndërprerjen dhe/ose cilësinë e dobët të shërbimeve të komunikimeve elektronike kur kjo ndodh për mungesën, pezullimin, ose prishjen e parametrave teknikë të cilësisë të pajisjeve të energjisë të godinave dhe/ose banesave;
- 4.6.7 Mungesën e ofrimit të shërbimeve ose cilësinë e dobët të tyre gjatë testimeve që kryhen nga operatori me qëllimin për të inspektuar pajisjet, lidhjet, rrjetet, etj, si edhe testet me qëllim përmirësimin apo efektshmërinë e shërbimit të ofruar, vetëm subjekt për pajtimtarin duke e mbajtur kete te fundit të informuar paraprakisht.
- 4.7 Operatori mund të ruajë kategoritë caktuara të dhënave për nevoja të mbrojtjes kombëtare si edhe për zbulime të kriminalitetit për një periudhë 24 muaj (me përjashtim të nxjerrjes së të dhënave mbi përmbajtjen e mesazheve) nën termat dhe kushtet e përcaktuara në legjislacionin referues.
- 4.8 Pajtimtari ka të drejte të përdorë shërbimin objekt kontrate në përputhje me termat e kësaj kontrate.
- 4.9 Pajtimitari ka te drejte te kërkojë ndryshime në shërbimet e ofruara, duke përfshirë por pa u kufizuar në parametra të shërbimit, cilësinë e shërbimit, shërbime shtesë, plane tarifore, adreses, etj. nëpërmjet kërkesave me shkrim drejtuar Operatorit.
- 4.10 Pajtimtari ka të drejte te kërkojë rilidhjen e Kontrates së Pajtimit, pas shlyerjes së te gjitha detyrimeve te prapambetura.

Neni 5 Faturimi dhe menyrat e pageses.

- 5.1 Faturimi per Pajtimtarin do të jetë me bazë mujore dhe do të kryhet sipas percaktimeve të tarifave dhe sherbimeve të zgjedhura nga Pajtimtari në këtë kontratë.
- 5.2 Fatura, për shërbimet e zgjedhura nga pajtimtari, i dorëzohet Pajtimtarit në mënyrë zyrtare (dorazi) në pikat e shitjes së Operatorit, në momentin e kryerjes së parapageses për sherbimin e internetit.
- 5.3 Pagesa kryhet ne LEK në dore prane njesive arketimore të Operatorit. Pagesa duhet të jete e rregullt dhe sistematike dhe kalendarike, duke respektuar daten në të cilën Pajtimtari duhet të parapaguaje çmimin për të marre sherbimin që është objekt i kontrates.

5.4 Fatura do të permbojë vlerën e gjithë shërbimeve të përdorura gjatë periudhës kalendarike së faturuar.

5.5 Ne faturen e dërguar Pajtimtarit, perveç vlerave te detyrimeve, Operatori mund te perfshije:

- Afatin e pagesës së faturës;
 - Çmimin e sherbimit;
 - Koston e instalimit kur aplikohet në varesi të kërkesave dhe afatit të kontrates që zgjedh klienti.
 - Çmimin i paisjeve në raste kur demtohen ose kur klienti i blene pasi parashikon se nuk do të jete rregullt me përafshirë 1 vjeçarë të kontratës.

Neni 7 Sanksionet

7.1Në rast se Pajtimtari nuk kryen parapagesen e fatures sipas afatit te saj, Operatori ka të drejtë të ndërmarrë sanksione dhe masa kufizuese të ofrimit të shërbimit për Pajtimtarin deri në përfundimin e kontratës.

7.2 I.B.C-Telecom do te aplikoj si sanksion vleren ne LEKE te instalimit, vler kjo e percaktuar sipas rastit ne Aneksin nr 1(nje), ne raste se Pajtimtari nuk permbush detyrimet kontraktore brenda vitit te pare.

Neni 8 Prishja e njeanshme e kontrates

8.1 Operatori ka të drejtë të ndërprese ofrimin e shërbimit dhe të perfundoje në menyre të njeanshme kontraten pa njoftim paraprak ndaj pajtimtarit ne rastet si me poshtë vijon :

a. Konstaton shkelje, sistematike apo të vazhdueshme të detyrimeve kontraktuale dhe ose të Termave të Përgjithshme të shërbimit. Në kuptim të këtij parashikimi me shkelje dhe shkelje sistematike të detyrimit kontraktual do të kuptohen:

a.1 "Shkelje e detyrimit kontraktual" është një shkelje që shkakton ose mund të shkaktojë dëm tek pajtimtarë/përdorues të tjerë ose tek operatori, me përjashtim të dëmit të shkaktuar nga prishja e detyrimit në rastet e "Forcës madhore".

a.2 “Shkelje sistematike e një detyrimi kontraktual” është një shkelje që ka ndodhur dy a më shumë herë brenda një periudhe raportuese sipas llojit të shërbimit të ofruar.

b. Pajtimtari me dashje dëmton/prish ose lejon shkatërrimin/dëmtimin/thyerjen/e modemit dhe ose pajisjeve te tjera të komunikimeve elektronike të ofruara nga operatori, nëse nuk paguan kompensim për çdo dëm dhe të gjitha dëmet aktuale të shkaktuara ndaj operatorit, perfshirë dhe kostot e pajisjes fundore.

c.Ne rastin kur Pajtimtari me dashje ne ambjentin e Operatorit perdor fjalë fyese dhe jashtë rregullave etike, duke i demtuar rendë imazhin Operatorit.

c. Sipas parashikimeve të nenit 7.1 pika b.

d.Në rast të forcës madhore.

8.2 Operatori dhe Pajtimtari, në çdo rast ka të drejtë të përfundojë këtë kontratë me një njoftim paraprak 30 ditor me shkrim.

Neni 9 Kushtet e pergjithshme

9.1 Kjo Kontratë hartohej dhe interpretohet nga Palët në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore të Republikës së Shqiperisë.

9.2 Ne rast se palët nuk arrijnë të zgjidhin mosmarrvëshjen me mirëkuptim, secila mund t'i drejtohet për shqyrtim AKEP ose Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkoder.

9.3 Kjo Kontratë hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të saj nga palët.

9.4 Kjo kontratë lidhet për një afat 1 vjeçar.

Neni 10 Paisjet ne perdom.

10.1 Operatori në perputhje me llojin e shërbimeve te zgjedhura nga Pajtimtari sipas Aneksit 1, jep pa pagesë në **përdorim** të Pajtimtarit paisjet e nevojshme per gjatë kohëzgjatjes së kësaj kontrate, ne perfundim te kontrates Pajtimtari është i detyruar t'i ktheje paisjet e marra ne gjendje të mire pune brenda 5 diteve nga data e perfunimit te kontrates (paisjet te cilat jane të percaktuara ne Aneksin 1).

10.2 Në raste se nga keqperdomimi apo mungesës së mirëmbajtjes nga pajtimtari të pajiseve këto të fundit dëmtohen rëndë apo bëhen të papërdorshme, operatori ka të drejtën e dëmshpërblimit për vlerën e plotë të paisjes së dëmtuara.

10.3 Paisjet e percaktuara ne Aneksin 1 të kesaj kontrate duhet të perdoren vetëm në perputhje me qëllimin per te cilin i janë dhënë në përdorim Pajtimtarit sipas objektit të kontratës.

Neni 11 Procedura e zgjidhjeve te ankesave.

11.1 Ankesat e pajtimtarut mbi sherbimin e ofruar nga Operatori mund të paraqiten :

a.Nëpermjet numrit të shkurtuar për “Difekte teknike” **+355682014700, +355697007025, 022600300, +355697007030, +355697007050, +355697007051.**

b. Nëpermjet numrit për “Asistencë teknike për shërbimin Internet” **+35522600700.**

c.Nëpermjet sporteleve të Operatorit ku merret deklarim shkresor për ankesën.

d.Me email në adresën : **info@ibc.al**

e. Per të përmirësuar cilësinë e shërbimit dhe për të ofruar shërbim te garantuar, çdo ankeze zanore dhe me shkrim do te rregistrohet nga Operatori.

11.2 Afati i paraqitjes së ankesave është:

a. Ankesat për “Difekte Teknike” dhe “Asistencë teknikë për shërbimin Internet” paraqiten nga ora 08.00-20.00 tek Nr. i shërbimit të klientit ose në çdo kohë tek adresa elektronike;

b.Ankesat për faturim paraqiten deri në fund të muajit të dyte pasardhes të faturës së ankumuar.

c.Ankesa për mosriparim të difekteve të paraqiten menjëhere pasi mbaron afati sipas pikave perkatese te kontrates.

d.Ankesat e tjera, te çdo lloji qofshin paraqiten sa më pare.

11.3 Ankesat , në varësi nga natyra e tyre, shqyrtohen nga strukturat perkatëse të Operatorit, mbështetur në të dhënat e marra nga Degët apo Sektorët e tjërë dhe konform rregullave bëhet analiza dhe zgjidhja e tyre, konform afateve te parashikuara në Kontratën e Pajtimit.

11.4 Afati i informimit të Pajtimtarit mbi rezultatin e shqyrtimit të ankesave sipas pikave 2.b, 2.c,2.d, dhe 2.e është brenda 15 ditëve nga marrja e tyre.

Kjo kontratë dhe gjithë elementet e saj hartohet në 2 (dy) kopje të njevlefshme ne gjuhën shqipe, nga të cilat 1 (një) kopje e mban Operatori dhe 1 (nje) kopje i dorëzohet Pajtimtarit. Të dy kopjet nënshkruhen nga të dy palet.

Me anë të këtij nenshkrimi vërtetoj se i kam lexuar, kuptuar dhe pranuar kushtet dhe termat e kesaj kontrate.

OPERATORI

“IBC”- Telecom Shpk

(Emri, mbiemri, firma, vula)

PAJTIMTARI:

(Emri, mbiemri, firma)

ANEKSI Nr.1

I kontrates se Pajtimit nr. _____ dt. _____

1. SHERBIMI I PERZGJEDHUR NGA PAJTIMTARI

A. TELEFONI FIKSE

Numer Telefoni Telefoni

B. AKSES NE INTERNET

- Doënload deri në _____ (kbps/Mbps);
- Upload deri në _____ (kbps/Mbps).

2. PLANI TARIFORE PER SHERBIMI I PERZGJEDHUR NGA PAJTIMTARI

A. Telefoni Fikse

A.1 Të gjithë abonentët që përdorin telefoninë fiksë do të kenë një vlerë të kredituar konform një marrëveshjeje paraprake të palëve kontraktore.

B. Akses në Internet

B.1 Pajtimtari në parim paguan vetem tarifen e standarte për Shërbimin e Aksesit në Internet, gjithmone ne qofte se parashikon se është i rregullt me pagesat per afatin 1 vjeçar te lidhjes se kontrates.

B.2 Pajtimtari duhet te paguaje Tarifen e Instalimit për Shërbimin e Aksesit në Internet me vlerë _____ lekë dhe vlerën e pajive, kur parashikon se kontrata nuk do të jetë 1 vjeçare.

B.3 Pajtimtari i cili nuk do të jetë i rregullt në marrjen e shërbimit të internetit sipas afatit të cilësuar në këtë kontratë, do të marrë shërbimin me anë të një Karte të parapaguar nga ana e tijë.

3. PAISJET NE PERDORIM

Operatori jep pa pagesë në përdorim të Pajtimtarit paisjët e mëposhtme përgjatë kohëzgjatjes 1 vjecare së kësaj kontrate:

- Modem _____ cope _____ Vlera _____

4. VLERA E INSTALIMIT NË LEKE _____.

OPERATORI

I.BC-Telecom sh.p.k

PAJTIMTARI

FORMULAR REGJISTRIMI
PER PERDORUESIT E SHERBIMIT TE AKSESIT NE INTERNET NE RRJETET FIKSE

Plotësimi I formularit bëhet me gërmë të mëdha shëtëpi

I. KATEGORIA E PËRDORUESIT

Personal	Biznes	
INDIVID <input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/> PERSON FIZIK <input type="checkbox"/> PERSON JURIDIK <input type="checkbox"/> INSTITUCIONE PUBLIKE TË TJËRA Emri i personit fizik/juridik/institucion publik e të tjerë <div style="border: 1px solid black; height: 30px; width: 100%; margin-top: 5px;"></div>	
		Numri I dokumentit të regjistrimit në organin tatimor (Çertifikat/NIPT) <div style="border: 1px solid black; height: 20px; width: 100%; margin-top: 5px;"></div>

II. REGJISTRIMI I PERDORUESIT PRANE SIPERMARRESIT BEHET NGA :

Përdoruesi	Personi i autorizuar	Kujdestari ligjor
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

III. DOKUMENTI I IDENTIFIKIMIT I PËRDORUR PËR REGJISTRIM:

Lloji i dokumentave të detyrueshme për regjistrim 1 E detyrueshme per persona mbi 18 vjeç <input type="checkbox"/> Leternjoftim ID(Karta e identitetit) sipermarrsi bën dhe ruan fotokopjen e saj	Të dhënat e dokumentit të identifikimit Numri Personal <div style="border: 1px solid black; height: 20px; width: 100%; margin-top: 5px;"></div>
2 Vetëm per persona nen 18 vjeç dhe te huaj : <input type="checkbox"/> Pasaport (sipërmarrësi bën dhe ruan fotokopjen e saj <input type="checkbox"/> Leternjoftim ID (Karta e identitetit)	Numri i pasaportes <small>Persona shtetas te huaj shenohet dhe shteti perkates</small> <div style="border: 1px solid black; height: 20px; width: 100%; margin-top: 5px;"></div>
3 Vetëm për personat e autorizuar/Kujdestar Ligjor <input type="checkbox"/> Autorizim/Prokurë (Per rastin e regjistrimit nga Person i Autorizuar) depozitohet Autorizimi/Prokura <input type="checkbox"/> Leternjoftim ID (Karta e Klientit) e Personit te Autorizuar / Kujdestar ligjot (sipërmarrësi bën dhe ruan fotokopjen e saj <input type="checkbox"/> Leternjoftim ID (Karta e Klientit) e perdoruesit (sipërmarrësi bën dhe ruan fotokopjen e saj	Numri Personal <div style="border: 1px solid black; height: 20px; width: 100%; margin-top: 5px;"></div>

IV. INFORMACIONI I PERDORUESIT TE SHERBIMIT

Emri	<input type="text"/>	Mbiemri	<input type="text"/>
Datëlindja	<input type="text"/> - <input type="text"/> - <input type="text"/>	Viti	<input type="text"/>
Vendlindja	Rrethi <input type="text"/>	Shteti	<input type="text"/>
Shenohet vetem per persona me një identifikimi ten një shteti te huaj			

V. IDENTIFIKIMI I PERDORUESIT NE RRJETIN E KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE

FORMULAR REGJISTRIMI
PER PERDORUESIT E SHERBIMIT TE AKSESIT NE INTERNET NE RRJETET FIKSE

Plotësimi i formularit bëhet me gërmë të mëdha shtypi

Menyra e identifikimit/autentifikimit te perdoruesit në rrjet

Adres IP statike

Tjeter

(sipermarrsi shenon menyren e identifikimit)

SHËNIM:

1. Regjistrimi i të dhënave sipas këtij formulari është detyrim i Ligjit 9918 dhe në rastet e parashikuara me ligj të dhënrat e këtij formulari dhe skedaret e komunikimeve u vihen në dispozicion autoriteteteve të përcaktuara në Kodin e Procedurave Penale, në bazë të kërkesës së tyre

2. Deklarimet e të dhënave të rreme apo paraqitja e dokumenteve të falsifikuara për regjistrim, përbëjnë krime të falsifikimit dhe/ose përdorimit të dokumenteve të falsifikuara, që parashikohen nga nenet 186, 189 ose 191 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

DEKLARIMI I PERDORUESIT:

1. Deklaroj se qëllimi i blerjes së shërbimit është për përdorimin tim personal/biznes apo të personit të deklaruar dhe jo për rishitje apo përdorim për qëllime fitimi apo në kundërshtim me ligjin.

2. Deklaroj që të dhënat e mësipërme janë të vërteta

3. Mora dijeni të plotë për shënimet dhe pranoj të gjitha kushtet e mësipërme

Përdoruesi /Personi i Autorizuar/ Kujdestari Ligjor

Për Sipërmarrsin:

(emër , mbiemër , nënshkrim)

(emër , mbiemër, nënshkrimi i personit të autorizuar)

Data e regjistrimit

data

muaji

viti

Qyteti

Për cdo informacion në lidhje me regjistrimin , prfshir ndryshimet e të dhënave
kontaktoni me sipërmarrsin në numrin pa pages _____